



Me rastin e Asamblesë së Tetë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prizren më 9 dhjetor 2009

Asambleja e përbërë nga Gjyqtarët: Maria Giuliana Civinini, Guy Van Craen, Angela Kaptein, Anna Bednarek, Antoinette Lepeltier-Durel, Arkadiusz Sedek, Christine Lindemann-Proetel, Dragomir Yordanov, Emilio Gatti, Eija-Liisa Helin, Ferdinando Buatier de Mongeot, Francesco Florit, Gerrit-Marc Sprenger, Gianfranco Gallo, Hajnalka Karpati, Harri Katara, Klaus Huner, Johanna Schokkenbroek, Nikolay Entchev, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vitor Pardal, Vladimir Kanev, Verginia Micheva-Ruseva

Merr VENDIM

Njëzëri, për aprovimin e këtij udhëzimi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Gjykatat e Kosovës lidhur me krijimin e sistemeve të regjistrimit.

K Ë S H I L L L Ë

Për:

- Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Kryetarët e Gjykatave të Qarkut dhe Komunale të Kosovës

Prej: Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it

Lënda: Këshillë për Gjykatat e Kosovës lidhur me krijimin e një sistemi të drejtë të caktimit të lëndëve.

1. Përmbledhje Ekzekutive

Siç parashihet me nenin 3 të Veprimit të përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian të Sundimit të Ligjit në Kosovë, ky mision ka për detyrë që të “(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat lidhur me sundimin e ligjit në tërësi (përfshirë shërbimin doganor), duke mbajtur disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive”.

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



Neni 2.4 i Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i datës 13 mars 2008 (Ligji nr. 03/L-053) përcakton se: *“përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovarë për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji nga ana e EULEX-it në KOSOVË”*.

Në veçanti, këshillimi përbëhet nga qëndrimet formale dhe zyrtare të marra në mënyrë të përbashkët nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it në Asambleshë e gjyqtarëve të EULEX-it dhe i drejtohen organeve vendore gjyqësore, legjislative apo qeveritare për të stimuluar veprimet e tyre në fushat përkatëse të përgjegjësisë të tyre. Me fjalë të tjera, këshillimi ka për qëllim sigurimin e këshillave profesionale për organet kompetente (Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kryetarët e Gjykatave, Gjykatën Supreme, Parlamentin, Fakultetin Juridik) rreth çdo çështjeje që del nga përvoja e monitorimit dhe udhëzimit. Këshillimi i siguron palës së interesuar kosovare informata të nevojshme për ndërhyrje në ato fusha të sistemit të drejtësisë të cilat kanë nevojë për përmirësime të përgjithshme dhe strukturale në tërë sistemin gjyqësor, të cilat nuk mund të zbatohen me anë të aktivitetit monitorues vetëm të gjyqtarëve të EULEX-it.

Kjo këshillë u drejtohet Kryetarëve të Gjykatave të Kosovës me qëllim të lejojë një administrim më të saktë dhe transparent të gjykatës, dhe një monitorim të besuar të rrjedhës së dokumenteve gjyqësore dhe jo-gjyqësore. Duke përmirësuar sistemin e caktimit të lëndëve me anë të harmonizimit dhe unifikimit, do të krijohet një praktikë në përputhje me ligjin e Kosovës dhe Praktikën më të mira Evropiane që rrit efikasitetin e drejtësisë në Kosovë.

2. Hyrje

Kjo këshillë pason dhe plotëson atë të mëparshmen të cilën e kishte miratuar Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it në mbledhjen e dytë të Asambleshë më 23 tetor 2009 drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Prandaj, nuk ka për qëllim të kundërshtojë por të jetë vazhdim i asaj në baza të barabarta me Gjyqtarët vendorë.

Këshillohet të miratohet dhe të zbatohet sistemi i caktimit të lëndëve i bazuar në kriteret e paracaktuara objektive në të gjitha gjykatat e Kosovës. Siç dëshmohet me anë të aktiviteteve të MUK-ut në mbarë Kosovën gjer tani, në shumë raste gjyqtarët caktohen në lëndë nga Kryetari i Gjykatës lëndë për

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



lëndë pa asnjë mënyrë transparente të paracaktuar. Kjo ndihmon të ashtuquajturën “pazarllëkun e gjyqtarit” që dërgon deri te të gjitha llojet e pretendimeve të ndikimit nëse jo edhe të korrupsionit të gjyqësorit. Qartazi, ky sistem nuk është në përputhshmëri me Standardet Evropiane.

Më 23 tetor 2008 Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it miratoi një sistem të caktimit të lëndëve për lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës, lidhur me lëndët që kryesohen nga Gjyqtarët e EULEX-it. Ky sistem caktimi përcakton rregullat për caktimin e Gjyqtarëve në lëndë duke u bazuar në kritere objektive dhe të paracaktuara.

Në Nenin III, 2.2. dhe 3.2. të këtij sistemi të caktimit të lëndëve ideja e përforcimit të pronësisë vendore pasqyrohet me faktin se anëtarët e kolegjit preferohen të jenë gjyqtarë vendorë të Gjykatës Supreme. Sipas sistemit të caktimit të lëndëve këta anëtarë të kolegjit caktohen në lëndë në bazë të orarit që përmbush elementet e sistemit objektiv dhe të parapërcaktuar.

Sistemi i caktimit të lëndëve është prezantuar dhe sqaruar gjyqtarëve vendorë në Gjykatën Supreme në një mbledhje në fund të muajit tetor 2008. Secili gjyqtar vendor në Gjykatën Supreme kishte marrë nga një kopje të tekstit në gjuhën shqipe dhe janë pyetur se a kishin ndonjë koment. Në një mbledhje më vonë Kryetari i Gjykatës Supreme tha se pasi kishte diskutuar këtë çështje me gjyqtarët vendorë nuk ishte asnjë vërejtje kundër këtij sistemi. Ai lajmëroi se gjyqtarët vendorë plotësisht do të mbështesin këtë sistem.

Përveç kësaj nga Kryetari i Gjykatës Supreme u kërkua të krijohet një sistem i ngjashëm për lëndët e punuara nga gjyqtarët vendorë në vetë Gjykatën Supreme. Pavarësisht nga vështirësitë që një sistem i tillë mund të hasë në fazën fillestare të studimit dhe zbatimit, tani konsiderohet si urgjentisht e domosdoshme të miratohet në tërë Gjykatat e Kosovës.

3. Rekomandimi

Zbatimi i sistemit të paracaktuar të caktimit të lëndëve, i bazuar në kritere objektive, është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të Sundimit të Ligjit në Kosovë. Ky sistem i zvogëlon mundësitë dhe rrezikun e ndikimit dhe korrupsionit në gjyqësor dhe si pasojë luan një rol të rëndësishëm në procesin e krijimit të një gjyqësori në Kosovë i cili do të pranohet nga popullata vendore.

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it fton Gjykatat që të ndërmarrin hapa me qëllim të planifikimit dhe krijimit të një sistemi të tillë në bashkëpunim dhe mbështetje të Gjyqtarëve të EULEX-it. Për këto arsye propozohet që Gjykatat e Kosovës të kontaktojnë dhe të bashkëpunojnë me Kryesinë e Gjyqtarëve të

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Pollicisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



EULEX-it dhe Gjyqtarët e EULEX-it në nivel të Gjykatave të Qarkut për të kërkuar këshilla dhe mbështetje për këto çështje. Gjyqtarët e EULEX-it dhe anëtarët e stafit të tyre do të jenë nderuar dhe të kënaqur të japin mbështetjen e tyre kolegëve vendorë Kosovarë për përmirësimin e këshilluar që do të përfitonte Gjyqësori Kosovar deh gjithë populli i Kosovës.

Për arsyet e lartpërmendura Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it

KËSHILLON

Gjykatat e Kosovës të miratojnë dhe të zbatojnë një sistem të caktimit të lëndëve që bazohet në kritere të paracaktuara dhe objektive.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu